



Roma Education Fund

ROMA EDUCATION FUND

Raporti vlerësues

SHQIPËRI

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Falënderime	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Popullsia rome në Shqipëri	9
Angazhimi i qeverisë dhe i donatorëve	12
Sistemi arsimor	16
Programet e REF në Shqipëri	24
Aneks 1: Indikatorët kryesorë për arsimin	29
Aneks 2: Administrata e arsimit publik	31
Aneks 3: Performanca e nxënësve në vlerësimet ndërkombëtare	35
Aneks 4: Niveli i angazhimit për përmirësimin e rezultateve të arsimit të romëve në Shqipëri	36
Aneks 5: Rezultatet e censusit	38
Bibliografia	39

PARATHËNIE

Ky dokument është pjesë e një serie raportesh vlerësimi të përgatitura nga Fondi Arsimor për Romët (REF). Ai synon të ofrojë një analizë mbi arsimin dhe reformat arsimore nga perspektiva e përfshirjes së fëmijëve romë në vendet që bëjnë pjesë në Dekadën e Përfshirjes së Romëve. Dokumenti gjithashtu shqyrton programet dhe aktivitetet të ndërmarra nga REF-i që prej krijimit të tij në 2005, dhe nënvizon tematikat dhe fushat e programeve ku REF-i planifikon të fokusohet gjatë tre viteve të ardhshme. Përveç se shërben si një mjet për programet e veta, REF-i shpreson që ky dokument do të ofrojë dhe një instrument i dobishëm për:

- Vendimmarrësit që synojnë të përmirësojnë politikat e arsimit, të cilat adresojnë hendekun arsimor ndërmjet romëve dhe jo-romëve.
- Përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët dëshirojnë të përmirësojnë efektshmërinë e programeve të tyre arsimore duke i bërë ato më të rëndësishme në reformat e përgjithshme arsimore të vendit të tyre.
- Zhvillimin e përgjithshëm dhe komunitetin e donatorëve, të cilët nevojitet të kuptojnë më mirë situatën që hasin fëmijët romë në mënyrë që të identifikohen ato fusha ku burimet e disponueshme mund të kenë një ndikim më të madh.

Informacioni i paraqitur në këtë dokument është diskutuar me përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri për të siguruar që dokumenti të paraqesë në mënyrë reale situatën aktuale dhe rekomandimet e bëra të jenë të zbatueshme. Dokumenti pasqyron situatën në kohën kur po përgatitej. Shumë nga vendet e Dekadës Rome po përjetojnë ndryshime relativisht të shpejta, dhe REF-i planifikon t'i përditësojë raportet vlerësuese rregullisht.

FALËNDERIME

Modeli origjinal për serinë e Raporteve Vlerësuese u përpunua nga Tunde Kovács-Cerović, Roger Grawe dhe Alexander Marc, të cilët gjithashtu redaktuan serinë e raporteve në fund të 2007. Raporti Vlerësues aktual ndjek një format të ri të përgatitur nga Toby Linden, Mihai Surdu dhe Eben Friedman në fillim të 2009. Redaktori i kësaj serie Raportesh Vlerësuese është Mihai Surdu.

Autorët kryesorë të këtij dokumenti janë Gjergj Sinani dhe Bujar Taho. Ata kanë marrë kontribute nga Nino Chelidze, Eben Friedman, Zoe Gray, Marius Taba dhe Marsela Taho, si dhe nga pjesëmarrësit në tavolinën e rrumbullakët të mbajtur në 9 nëntor 2010 në Tiranë.

PËRMbledhje Ekzekutive

ROMËT NË SHQIPËRI

Pasi regjistrimi i përgjithshëm i popullsinë në 2001 në Shqipëri nuk përfshiu pyetje mbi etninë dhe identitetin gjuhësor, nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e popullsinë rome në vend. Sipas llogaritjeve jozyrtare, numri i romëve në Shqipëri varion nga 80.000 deri në 150.000, ose nga 2,5% dhe 4,7% e popullsisë së përgjithshme. Ndërsa nuk ka të dhëna zyrtare as për popullsinë egjiptiane, OJQ-të e ndryshme vlerësojnë se numri i tyre i kalon 200.000. Megjithëse shumë jo-romë dhe romë i shikojnë egjiptianët si romë, anëtarët e këtij grupi e konsiderojnë veten të ndryshëm nga romët mbi baza historike, gjuhësore dhe kulturore. Përderisa egjiptianët dhe të tjerë në Shqipëri përballen me të njëjtat probleme si romët për të pasur arsim cilësor, edhe anëtarët e këtyre grupeve përbëjnë kandidatë për përfshirje në aktivitetet e mbështetura nga Fondi Arsimit për Romët (REF).

ARSIMI

Megjithëse qeveria shqiptare miratoi *Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom* në 2003 që përfshinte masa të ndryshme në fushën e arsimit, një raport progresi në 2007 tregoi shumë pak progres në zbatimin e masave. Për më tepër, përpjekje të pandërprera për të reformuar sistemin arsimor në Shqipëri filluan vetëm në 2008.

Numri i ulët i regjistrimeve përbën një nga problemet më urgjente për arsimimin e romëve në Shqipëri. Nga ana tjetër, fëmijët romë të cilët frekuentojnë shkollën shpesh hasin diskriminim, përfshirë (por jo vetëm) uljen e fëmijëve romë veç nga fëmijët e tjerë. Ka shumë pak mësues të kualifikuar me origjinë rome dhe vetëm një rom të punësuar në një institucion kryesor të sistemit të arsimit. Gjithashtu, në arsimin e përgjithshëm dhe kurrikulën e trajnimit të mësuesve nuk i kushtohet vëmendje romëve si pjesë integrale e historisë dhe kulturës shqiptare.

Përparime të rëndësishme në arsimimin e romëve në Shqipëri përfshijnë miratimin e politikave që synojnë të sigurojnë që të gjithë fëmijët të kenë akses për libra shkollorë, ndërtimin dhe rinovimin e ambienteve shkollorë që shërbejnë për arsimin parashkollor dhe atij bazë, reduktimin e barrierave administrative për regjistrimin në shkollë dhe futjen e programeve të shansit të dytë për të rinjtë që kanë braktisur shkollën.

UDHËZIME STRATEGJIKE PËR AKTIVITETET E ARDHSHME TË REF-IT

Financimi i REF-it në Shqipëri për 3 vitet e ardhshme do të marrë parasysh prioritetet e mëposhtme:

- Të sigurojë akses për fëmijët romë për të pasur arsimim parashkollor cilësor dhe të integruar.
- Të parandalojë braktisjen e hershme të shkollës nëpërmjet masave që përshijnë rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rëndësinë e arsimimit, sigurimin e mbështetjes materiale (p.sh. ushqim, mjete shkollore, libra shkollore) e nevojshme për pjesëmarrjen në shkollë, dhënien e mbështetjes pas shkollës në vitet e para të arsimit bazë dhe promovimin e edukimit ndërkulturor me stafin e mësuesve dhe administratën shkollore.
- Të mbështesë projekte pilote në fushën e arsimimit të të rriturve si një mjet për të rritur kapacitetet e prindërve romë për të mbështetur edukimin e fëmijëve të tyre ndërsa kontribuojnë njëkohësisht dhe për punësimin e tyre.
- Të krijojë mundësinë për mbështetje akademike për studentë në arsimin e mesëm dhe të lartë, duke u nisur nga eksperiencia e REF-it në Hungari, Maqedoni dhe Serbi.

Çështjet kryesore të kërkimit dhe aktiviteteve mbi politikën në Shqipëri do të përfshijnë:

- Një vlerësim me metodologji të mirëfilltë kualitative dhe/ose kuantitative mbi përfaqësimin e romëve në arsimin special.
- Një përmbledhje mbi iniciativat e qeverisë vendore për të përmirësuar situatën e shkollimit të romëve.

Prioritetet të Programit të Bursave të REF në Shqipëri do të përfshijnë:

- Rritjen e numrin të bursantëve të RMUSP me një theks të veçantë në zonat rurale dhe zona të tjera të margjinalizuara.
- Krijimin e një rrjeti të përfituesve.
- Promovimin e pjesëmarrjes së bursantëve në aktivitete të tjera të REF-it.



POPULLSIA ROME NË SHQIPËRI

HISTORIA DHE NUMRI I POPULLSISË

Në mungesë të të dhënave të sigurta që vërtetojnë se kur kanë ardhur romët në territorin shqiptar, supozime të historianëve e vendosin ndërmjet shekullit të trembëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë.¹ Si edhe në vende të tjera të Ballkanit, megjithëse romët kanë jetuar zakonisht në skajet e shoqërisë, si një rregull i përgjithshëm ata nuk kanë qenë objekti i politikave që synonin eliminimin e tyre. Ndërsa ka shumë pak të dhëna të dokumentuara lidhur me trajtimin e romëve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, duket se popullsia rome u ruajt nga asgjësimi në masë si rezultat i zvarritjes nga ana e autoriteteve lokale fashiste.² Romët nuk kishin status zyrtar si grup veçantë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Megjithëse romët në Shqipërinë e ditëve të sotme janë të njohur si një minoritet etno-gjuhësor, censusi i 2001 nuk përfshiu pyetje mbi etninë dhe identitetin gjuhësor. Sipas llogaritjeve jozyrtare, numri i romëve në Shqipëri varion nga 80.000 deri në 150.000, ndërmjet 2,5% dhe 4,7% e popullsisë së përgjithshme prej 3,8 milionësh. Rritja e hamendësuar e popullsisë rome është 3%, më i lartë se ai i popullsisë shqiptare që është rreth 1,9%.³ Romët janë të shpërndarë pothuajse në të gjithë territorin e vendit (kryesisht në lagje të veçuara) ose në fshatra afër qyteteve. Numri më i madh i romëve është përqendruar në Shqipërinë qendrore dhe juglindore në zonat e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Beratit, Korçës, Pogradecit, Bilishtit, Gjirokastrës, Delvinës, Krujës dhe Shkodrës.⁴

Megjithëse shumë jo-romë dhe romë i shikojnë egjiptianët si romë, anëtarët e këtij grupi e konsiderojnë veten të ndryshëm nga romët mbi baza historike, gjuhësore dhe kulturore. Ndryshe nga romët, egjiptianët flasin vetëm shqip. Nuk ka të dhëna zyrtare, por OJQ-të egjiptiane pretendojnë se numri i tyre i kalon 200.000. Egjiptianët kanë

¹ Shih, p.sh. Donald Kenrick, *Gypsies: From India to the Mediterranean [Romët: Nga India në Mesdhe]* (Toulouse: Gypsy Research Center/CRDP Midi Pyrenees, 1993); John Kolsti, "Albanian Gypsies: The Silent Survivors [Romët shqiptarë: Të mbijetuarit e heshtur]", në David Crowe dhe John Kolsti (red.), *The Gypsies of Eastern Europe [Romët e Evropës Lindore]* (Armonk: M.E. Sharpe, 1991); George C. Soulis, *The Gypsies in the Byzantine Empire and the Balkans in the Late Middle Ages [Romët në Perandorinë Bizantine dhe Ballkan në Fund të Mesjetës]*, *Dumbarton Oaks Papers*, nr. 15 (1961): 142-65.

² John Kolsti, "Albanian Gypsies: The Silent Survivors [Romët shqiptarë: Të mbijetuarit e heshtur]", në David Crowe dhe John Kolsti (red.), *The Gypsies of Eastern Europe [Romët e Evropës Lindore]* (Armonk: M.E. Sharpe, 1991).

³ United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania [Në rrezik: Prekshmeria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]*. (Tiranë: UNDP Albania, 2006).

⁴ Këshilli i Ministrave, *Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom* (Tiranë, Fletorja zyrtare, 2003).

⁵ United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania [Në rrezik: Prekshmeria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]*. (Tiranë: UNDP Albania, 2006).

relativisht një nivel arsimor më të mirë se romët, por një e katërta e tyre nuk është fare e arsimuar.⁵ Përderisa egjiptianët dhe të tjerë në Shqipëri përballen me të njëjtat probleme si romët për të pasur arsim cilësor, edhe anëtarët e këtyre grupeve përbëjnë kandidatë për përfshirje në aktivitetet e mbështetura nga Fondi Arsimit për Romët (REF).

SITUATA E PËRGJITHSHME E POPULLSISË ROME

Varfëria dhe papunësia

Të ardhurat mesatare për frymë për komunitetin rom janë afërsisht 3.3 herë më të ulëta se e popullsisë jo-rome, dhe pothuaj 80% e komunitetit rom jeton poshtë këtij kufiri varfërie.⁶ Të ardhurat mesatare në muaj të një familjeje rome sipas një studimi ishin 68 EUR, e krahasuar me 174,5 EUR për jo-romët që jetojnë afër romëve.⁷ Të ardhurat mujore të 51% të romëve nuk i kalojnë 50 EUR, ndërsa gjysma e popullsisë jo-rome fiton të ardhura që i kalon 150 EUR në muaj.⁸ Informacion i disponueshëm sugjeron gjithashtu se egjiptianët jetojnë në varfëri.

Si rezultat i shkallës së lartë të analfabetizmit (48% e romëve e krahasuar me 3% e jo-romëve), një niveli jashtëzakonisht të ulët arsimor dhe kualifikimi, si dhe diskriminimit, romët kanë një numër më të lartë papunësie dhe papunësie afatgjatë krahasuar me popullsinë jo-rome.⁹ Vetëm 8% e të anketuarve nga shumica ishin të papunë, dhe 24% nga romët. Veçanërisht gratë dhe të rinjtë janë të prekur negativisht. Kohëzgjatja e papunësisë ndër romët është një shqetësim, me 73% të romëve të papunë që nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar dhe me papunësinë afatgjatë më të lartë për romët që kanë nivel të ulët arsimor.¹⁰ Sektori informal është burimi kryesor për punë. Në shumicën e rasteve romët bëjnë punë të pakualifikuar, me kohë të pjesshme ose punë të rastit, duke përfshirë këtu tregtinë e rrobave të përdorura, punën si muzikantë, riciklimin e kanoçeve dhe hekurishteve, bujqësinë dhe punën në ndërtim.¹¹

Shëndeti

Të dhënat zyrtare mbi gjendjen e shëndetit të romëve në Shqipëri janë të pamjaftueshme. Është e sigurt që shëndeti i romëve është përkeqësuar më shumë se për pjesën tjetër të popullsisë gjatë tranzicionit. Shifrat tregojnë një prani të lartë të sëmundjeve pulmonare dhe azmës ndër romët.¹² Gjithashtu ka dhe mungesë akses

⁶ Ibid., f. 8; Halil Dundar et al., *Poverty and Education in Albania: Who Benefits from Public Spending [Varfëria dhe Arsimi në Shqipëri: Kush përfiton nga fondet publike]* (Washington, DC: World Bank, 2005).

⁷ United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania [Në rrezik: Prekshmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]*. (Tiranë: UNDP Albania, 2006), f. 8.

⁸ Ibid., f. 9.

⁹ Ibid., f. 22.

¹⁰ Ibid., f. 30.

¹¹ Ibid., f. 27.

¹² Ibid., f. 18.

në shërbimet e shëndetit publik për shkak të mospasjes së dokumenteve të regjistrimit civil, i cili në vetvete është rezultat i faktit që shumica e romëve ose janë të punësuar në sektorin informal ose të papunësuar pa u regjistruar si të tillë.

Strehimi

Kushtet e strehimit janë përkeqësuar për shumë familje rome që prej ndryshimit të regjimit. Familjet që lëvizën nga fshatrat dhe u vendosën në periferi të qyteteve ndërtuan kasolle ose lloje të tjera banesash të thjeshta dhe jetojnë pa infrastrukturën e nevojshme dhe janë të rrezikuar të dëbohen.¹³

Përfaqësimi

Romët nuk kanë qenë të aftë të kenë përfaqësuesin e tyre në Parlament dhe e vetmja parti që përfaqëson minoritetet kombëtare nuk ka mbështetur asnjëherë ndonjë kandidat rom për zgjedhjet e përgjithshme. Nuk ka rregulla ligjore për përfaqësimin e minoriteteve kombëtare ose gjuhësore në njësitë e qeverisjes lokale. Megjithatë pak romë janë aktualisht anëtarë të këshillave bashkiakë/komunalë në disa njësi administrative (në Elbasan, Fier dhe Tiranë), ku shumica e romëve të zgjedhur vijnë nga sektori i OJQ-ve.

Vetëm pak romë janë të zgjedhur ose të punësuar në administratën publike në nivelin qendror dhe lokal. Për më tepër, shumica e punësuarve në institucionet publike kanë pozicione të kategorisë së ulët.

¹³ European Commission against Racism and Intolerance, *ECRI Report on Albania (Fourth Monitoring Cycle)* [Raporti i ECRI mbi Shqipërinë (Cikli i katërt monitorues)] (Strasbourg: Council of Europe, 2010).

ANGAZHIMI I QEVERISË DHE I DONATORËVE

INSTITUCIONET QEVERITARE

Megjithëse politikat për Romët në Shqipëri dhe mbledhja e të dhënave të ndara sipas etnive që t'i drejtojnë këto lloj politikash patën një fillim të ngadaltë, vitet e fundit kanë sjellë disa ndryshime në të dyja drejtimet.

Kuadri i përgjithshëm ligjor

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e instrumenteve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me përjashtimin e vetëm të Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon barazi përpara ligjit dhe ndalon me ligj diskriminimin e padrejtë mbi baza të ndryshme përfshirë dhe etninë. Lejon diskriminim afirmativ kur ka një qëllim të pranueshëm dhe një arsye objektive duke lënë vend për veprime pozitive.¹⁴ Në këtë drejtim, legjislacioni shqiptar mbi asistencës sociale e lehtëson aksesin për familjet rome për të përfituar.¹⁵ Kodi Penal konsideron shkelje çdo diskriminim nga një nëpunës publik bazuar në baza etnike. Sanksionet variojnë nga gjyba deri në 5 vjet burg.¹⁶ Kodi i Punës gjithashtu e ndalon diskriminimin dhe kodi i Procedurës Administrative përfshin parimin e trajtimit të barabartë në bashkëveprimin ndërmjet nëpunësve të administratës publike dhe minoriteteve kombëtare.¹⁷

Ligji për “Mbrojtjen nga të Gjitha Format e Diskriminimit në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi në mars 2010, ndalon diskriminimin mbi disa baza, përfshirë dhe etninë dhe gjuhën, në fushën e punës, arsimit dhe shërbimeve. Për më tepër, kapitulli mbi arsimin ndalon diskriminimin në institucionet arsimore, dhe autorizon “masa të veçanta” të përkohshme për të kaluar diskriminim historik dhe për të promovuar barazi në arsim. Ndërsa është zgjedhur një komisioner për mbrojtje të barabartë për të shqyrtuar ankesat dhe që është i autorizuar të vendosë sanksione, si p.sh. gjyba për shkelësit e dispozitave të ligjit për anti-diskriminim, deri tani nuk ka pasur asnjë çështje në gjykatat shqiptare që të tregojë efektshmërinë e këtyre normave.

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 18.

¹⁵ Shih Ligji nr. 9355, datë 14.2.2005 Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe masave për ndihmën ekonomike, *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 98.

¹⁶ Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 2, Neni 253.

¹⁷ Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 19, Neni 11.

Një tjetër hap i rëndësishëm ligjor u mor me miratimin në nëntor 2010 të Ligjit “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”. Ky ligj siguron të drejtën e fëmijëve që i përkasin minoriteteve kombëtare të shprehim lirisht identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

Aktualisht në proces rihartimi, Ligji “Për Arsimin Parauniversitar” i 1995 parashikon arsim falas, si dhe klasa ose shkolla të veçanta për minoritetet etnike në gjuhën e tyre.¹⁸ Megjithatë në praktikë këto dispozita nuk aplikohen për romët si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të mësuesve të kualifikuar të gjuhës rome dhe mungesës së një kurrikule për gjuhën dhe kulturën rome.

Masa për romët

Romët janë të përfaqësuar në Komitetin Shtetëror për Minoritetet në Këshillin e Ministrave, i cili shërben si një organ këshillimor pranë zyrës së kryeministrit. Megjithatë deri më sot ky organ nuk ka pasur shumë influencë mbi politika.

Qeveria aprovoi *Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom në 2003*. Strategjia adreson pesë fusha të gjera duke përfshirë dhe arsimin, ku i jep prioritet klasave plotësuese për mësimin e gjuhës shqipe, siguron për mësim në gjuhën minoritare vetëm në ato zona me popullsi të lartë rome dhe promovon bursa dhe subvencione si mjet për të përmirësuar arsimimin e romëve. Megjithëse OJQ-të u përfshinë në procesin e përgatitjes së strategjisë dhe dokumenti final prek çështjet e rinisë dhe gjinisë, disa formulime në *Strategji* janë problematike, si p.sh. propozimi për të studiuar “mënyrën e jetesës së romëve” me objektivin për “ta ndryshuar” atë. Përveç kësaj, problematike është mungesa e të dhënave bazë, e përgjegjësive të qarta për zbatimin e saj dhe e një buxheti duke ia transferuar përgjegjësinë në shumë raste OJQ-ve rome për të implementuar masa të përfshira në *Strategji*. Në 2007 një raport progresi i përgatitur nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) me mbështetjen e UNDP-së tregoi shumë pak progres në zbatimin e *Strategjisë* dhe bëri thirrje për rishikimin e saj.¹⁹ Dy vjet më vonë, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës i kërkoi qeverisë shqiptare të rrisë shpërndarjen e burimeve si për monitorimin në nivelin qendror ashtu dhe për zbatimin e *Strategjisë* në nivelin lokal. Gjithashtu i kërkoi shtetit që të përfshijë më mirë ministrinë e rëndësishme, autoritet lokale dhe komunitetin rom.²⁰

¹⁸ Estevan Ikononi, Bardhyl Musai, dhe Kseanela Sotirofski, *Mapping Policies and Practices for the Preparation of Teachers for Inclusive Education in Contexts of Social and Cultural Diversity: Albania Country Report [Planifikimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për një arsim gjithëpërfshirës në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor: Raporti vendor për Shqipërinë]* (Torino: European Training Foundation, 2010).

¹⁹ Rajmonda Duka, *Raport Progresi mbi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom*, (Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2007).

²⁰ European Commission against Racism and Intolerance, *ECRI Report on Albania (Fourth Monitoring Cycle) [Raporti i ECRI mbi Shqipërinë (Cikli i katërt monitorues)]* (Strasbourg: Council of Europe, 2010), f. 29.

Shqipëria iu bashkua Dekadës së Përfshirjes së Romëve në korrik 2008. Një komitet ndërministror i drejtuar nga zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta punoi me UNDP-në për të përgatitur Planin Veprues të Dekadës, të cilin e paraqet si një plan operativ që plotëson *Strategjinë*. Në fakt, Plani Veprues rishikon dhe përditëson *Strategjinë* dhe merr parasysh studime të ndryshme sociale dhe ekonomike duke ofruar informacion bazë për çdo fushë prioritare të Dekadës. Bashkë me arsimin, punësimin, shëndetin dhe strehimin, Plani Veprues i Dekadës në Shqipëri ka edhe dy fusha të tjera: trashëgiminë kulturore dhe administratën publike. Objektivat janë rishikuar nga çdo ministri e linjës duke u këshilluar me OJQ-të rome dhe me përfaqësues të qeverisë lokale, dhe çdo veprim ndiqet nga indikatorë të qartë. Përmirësime të rëndësishme në *Strategji* përfshijnë ndarjen e përgjegjësi për zbatim dhe monitorim, si dhe përfshirjen e informacionit mbi kohëzgjatjen, koston dhe burimeve financiare. Gjithashtu, një ndihmesë për zbatimin e Planit Veprues në nivelin lokal është dhe krijimi i komiteteve rajonale për shërbimet sociale në prill 2010.

Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom përmendet në mënyrë të veçantë në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007–2013*, që gjithashtu premtonte mbështetje për programe trajnuese profesionale për romët.²¹

PROGRAME TË FINANCUARA NGA DONATORË

Që prej 2007 Shqipëria përfiton asistencë financiare nën Instrumentin e Ndihmës së Parazgjerimit (IPA). Komisioni Evropian ka shpërndarë një shumë prej 70,7 milionë EUR në 2008. Gjatë 2006-2007, ndihma e huaj në mbështetje të arsimit dhe kualifikimin profesional ka ardhur nga Bashkimi Evropian (kryesisht përmes CARDS), si dhe nga qeveria austriake dhe zvicerane. Në të njëjtën kohë mbështetje për arsimin e lartë kanë dhënë Këshilli i Evropës, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore, si dhe qeveria italiane. Nga ana tjetër, në periudhën 2000-2005 mbështetja e donatorëve u fokusua kryesisht në ndërtimin dhe rinovimin e ambienteve shkollore, me një total prej afërsisht 18 milionë dollarësh të dhënë në këtë periudhë nga donatorët përfshirë këtu dhe Bashkëpunimin Ekonomik Azi-Paqësor, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (NOSA), UNICEF-in dhe Bankën Botërore.²²

Që prej 2008, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Shqipëri ka financuar projektin e quajtur "Arsim Alternativ dhe Formim Profesional" (CEFA). I zbatuar nga organizata "Ndihmë për fëmijët" dhe MPÇSSH, projekti fokusohet në integrimin e fëmijëve romë dhe familjeve të tyre përmes arsimit formal/profesional, mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Në fazën aktuale të projektit, afërsisht rreth 320 fëmijë romë ndjekin shkollat publike në qytetet e Beratit, Elbasanit, Korçës, dhe Tiranës. Përveç kësaj 160 romë të tjerë pritet të përfitojnë nga trajnime

²¹ Këshilli i Ministrave, *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007–2013* (Tiranë: Këshilli i Ministrave, 2008).

²² Ministria e Arsimit dhe Shkencës, *Education for All/Fast Track Initiative (EFA/FTI) Proposal [Propozim për arsimin gjithëpërfshirës/iniciativa përshpejtuese (EFA/FTI)]* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2005).

profesionale të certifikuara. Buxheti i projektit për 2009–2011 është 1.450.000 Euro.

Një tjetër iniciativë e rëndësishme është programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara “Fuqizimi i Komuniteteve Vulnerabël në Shqipëri”. I lançuar në prill 2010 me një buxhet prej 2.700.000 USD, programi është duke u implementuar në zona të banuara nga romë dhe egjiptianë në rajonet e Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe Tiranës me qëllim mbështetjen e komunitetit për pjesëmarrje në vendimmarrjen lokale; rritjen e aksesit të komunitetit për shërbimet dhe të drejtat sociale; dhe përforcimin institucional për përfshirje sociale. Ndër masat e parashikuara për të arritur këto qëllime është krijimi i një rrejtë me mediatorë për shëndetin, mbrojtjen e fëmijëve dhe arsimin.

Nuk ka të dhëna të sakta mbi investimet vjetore totale për arsimimin e romëve në Shqipëri. Gjithashtu, deri vonë ka pasur pak shkëmbim informacioni dhe koordinim ndërmjet donatorëve aktivë në Shqipëri.



SISTEMI ARSIMOR

STRUKTURA

Përpjekje të pandërprera për të reformuar sistemin arsimor në Shqipëri filluan vetëm në 2008 me decentralizimin qysh në fazat e para. Në nivelin qendror, Instituti për Kërkime Pedagogjike koordinon proceset e përmirësimit të kurrikulave. Gjithashtu, Sektori i Arsimit Fillor dhe Parashkollor në Departamentin e Kurrikulave në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës merret me çështje që lidhen me arsimimin e minoriteteve në përgjithësi dhe ndjek zbatimin e *Strategjisë për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom* në veçanti.

Në nivelin rajonal, Drejtoritë Arsimore Rajonale nën Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës operojnë me misionin për të këshilluar dhe inspektuar shkollat. Në nivelin lokal, autoritetet lokale janë përgjegjëse për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore. Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe autoritetet lokale duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si dhe me OJQ-të romë për krijimin dhe zbatimin e programeve për të mbështetur arsimimin e fëmijëve romë.

Informacioni i disponueshëm na tregon se vetëm një rom i punësuar në strukturën arsimore në Shqipëri është drejtor i Departamentit Kulturor në Drejtorinë Arsimore Rajonale në Fier.

FINANCIMI

Shpenzimet e qeverisë për arsimin llogariten rreth 3,5% të prodhimit të brendshëm bruto në 2008.²³ Kjo e pozicionon Shqipërinë poshtë mesatares së OECD-së (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) që llogaritet rreth 5,7%.²⁴ Shpenzimet operative të shkollave, përfshirë mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore, ujin, energjinë elektrike dhe telefonin, mbulohen nga një transfertë e Ministrisë së Financave të njësitë e qeverisë lokale në formën e një granti bllok. Ky grant, shuma e së cilit varet nga popullsia, zona dhe koeficienti i urbanizimit, nuk është veçanërisht për arsimin, pasi supozohet gjithashtu që njësitë e qeverisë lokale të financojnë dhe shërbime të tjera publike me të.²⁵

²³ Estevan Ikononi, Bardhyl Musai, dhe Kseanela Sotirofski, *Mapping Policies and Practices for the Preparation of Teachers for Inclusive Education in Contexts of Social and Cultural Diversity: Albania Country Report* [Planifikimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për një arsim gjithëpërfshirës në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor: Raporti vendor për Shqipërinë] (Torino: European Training Foundation, 2010).

²⁴ Organisation for Economic Co-operation and Development, *Education at a Glance 2010: OECD Indicators* [Arsimi me një shikim 2010: Indikatorët e OECD-së] (Paris: Organisation for Economic Co-operation and Development, 2010).

²⁵ Halil Dunder et al., *Poverty and Education in Albania: Who Benefits from Public Spending* [Varfëria dhe Arsimi në Shqipëri: Kush përfiton nga fondet publike] (Washington, DC: World Bank, 2005).

Ndërsa vendimet lidhur me caktimin e stafit në shkolla bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, vendimet për shpërndarjen e pajisjeve dhe materialeve mësimore merren në nivelin rajonal. Nga ana tjetër, vendimet për shpenzime për veprime, mirëmbajtjen dhe riparime të vogla merren nga njësitë e qeverisjes lokale. Ky fragmentim ka krijuar disa sfida që kanë sjellë në shumë raste paefektshmëri dhe shpërndarje të pabarabartë të burimeve.

Arsimi bazë dhe i mesëm në institucionet publike është falas për të gjithë nxënësit. Arsimi para-shkollor dhe i lartë nuk janë falas, por as të detyrueshëm.

INFRASTRUKTURA SHKOLLORE

Gjatë 2004–2006, Ministria e Arsimit dhe Shkencës financoi ndërtimin e 31 shkollave të reja dhe rehabilitimin e 376 të tjerave në të gjithë vendin. Si rezultat i një skeme me grant blloqe që u shpjegua më sipër, shpenzimet për arsimin variojnë shumë nga bashkia apo komuna. Në të njëjtën kohë, decentralizimi fiskal ka krijuar mundësinë për autoritetet lokale që t'i shpenzojnë fondet e tyre për rindërtimin e kopshteve dhe shkollave kur kanë qenë të aftë për t'i mobilizuar ato. Si rezultat i kësaj, pesë kopshte dhe shkolla u ndërtuan në Tiranë gjatë 2004–2006. Gjithashtu, që prej 2007 Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka dhënë grante për financimin e ambienteve shkollore me konkurs duke i dhënë prioritet grupeve në nevojë, përfshirë dhe romët.

CIKLET SHKOLLORE DHE KRITERET E PROGRESIT

Arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri, por po merret në konsideratë seriozisht plani për ta bërë një vit parashkollë të detyrueshëm. Arsimi bazë zgjat nëntë vjet dhe është i detyrueshëm. Arsimi i mesëm, që nuk është i detyrueshëm, ofrohet në tri lloje shkollash: shkollë e mesme e përgjithshme, profesionale dhe teknike. Provimet përmbyllëse jepen në fund të klasës së nëntë dhe të dymbëdhjetë.

ARSIMI SPECIAL

Megjithëse nuk ka të dhëna të ndara sipas etnive që mund të na lejojnë të llogarisim përqindjen e romëve në arsimin special, informacioni i disponueshëm sugjeron se romët mund të mos jenë të mbiprezantuar në arsimin special në Shqipëri si në vendet e tjera të Dekadës.

ARSIMI MULTIKULTUROR

Arsimi publik në Shqipëri ofrohet në shqip, greqisht dhe maqedonisht, por ka dhe institucione private që ofrojnë mësim në gjuhë të tjera. Megjithëse gjuha rome është gjuha e parë e pothuajse të gjithë romëve në vend, nxënësit romë në shumicën e rasteve e ndjekin mësimin në shqip. Përveç kësaj, informacion mbi historinë dhe kulturën e romëve është përfshirë shumë rrallë në kurrikulën shkollore pavarësisht mundësisë së shkollave dhe bordit të prindërve për të përshtatur kurrikulën me kushtet lokale. Gjithashtu numri i mësuesve romë të kualifikuar është shumë i vogël.

Mbi 90% e nxënësve romë pranojnë të jenë quajtur "gabel" ose "të zinj" nga nxënësit e tjerë ose mësuesit, ndërsa më shumë se 80% e tyre raportojnë se ulen në radhët e mesit ose të fundit të klasës.²⁶ Për më tepër, shkolla në zona me popullsi të lartë rome etiketohen nganjëherë si "shkolla romësh/gabelësh". Kjo bën që prindërit jo-romë t'i transferojnë fëmijët e tyre në shkolla të tjera. Nga ana tjetër, Inspektoratet Arsimore Rajonale zhvillojnë sesione trajnuese mbi edukimin ndërkulturor dhe mosdiskriminimin, dhe prindër romë janë gjithnjë e më shumë prezentë në bordet e prindërve. Por mungesa e hapësirës kushtuar programeve trajnuese për mësues për të zhvilluar kompetenca në arsimin gjithëpërfshirës mbetet akoma një problem, njësoj si dhe standardet pranuese dhe statusi social i profesionit të mësuesit.

MBËSHTETJE SOCIALE PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT

Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar parashikon klasa përgatitore për fëmijët nga grupet në nevojë (duke përfshirë këtu dhe fëmijët romë), të cilët futen në klasën e parë të arsimit bazë.²⁷ Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 36 fëmijë romë u regjistruan në këto klase në vitin akademik 2009-2010. Në të njëjtën mënyrë, *Strategjia Kombëtare dhe Plani Veprues për Fëmijët* i 2005 sugjeron për dhënien e bursave për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve romë në arsimin e detyrueshëm, por në praktikë nuk është ndarë veç asnjë bursë për romët dhe nuk ka informacion se sa fëmijë romë kanë përfituar.²⁸ Si përfundim, njësitë e qeverisë vendore janë përgjegjës për të ofruar transport për t'i mundësuar fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë larg shkollave t'i frekuentojnë ato, por kushtëzimi i këtij shërbimi nga disponueshmëria e fondeve ka bërë që vetëm tre qeveri vendore të kenë pasur mundësi të ofrojnë transport për një total prej 109 fëmijë romë.

²⁶ Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri*, (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 12.

²⁷ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, *Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2009-2013* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2008).

²⁸ Shih Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Fëmijët* (Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2005).

Që prej 2003, ka pasur disa politika të qeverisë për të siguruar libra shkollorë për nxënësit e arsimit bazë nga familjet në nevojë. Sipas skemës së tanishme, të iniciuar në 2009, kostoja e librave shkollorë është e rimbursueshme plotësisht për nxënësit nga familjet që marrin ndihmë sociale. Por në praktikë, librat u morën më vonë dhe shumica e prindërve romë nuk u kualifikuan për rimbursim, ose sepse nuk ishin të regjistruar si të papunë ose sepse nuk i përmbushin kriteret për të përfituar asistencë sociale. Për më tepër, disa prindër që kualifikoheshin për skemën e rimbursimit raportuan që nuk ishin në gjendje për të gjetur të ardhurat e nevojshme për të blerë librat në avancë. Gjithashtu, ka pasur vonesa me rimbursimet, prandaj skema nuk mund të konsiderohet një sukses nga pikëpamja e promovimit të pjesëmarrjes së plotë të romëve në arsimim.

Në disa rajone të Shqipërisë, fëmijë dhe të rinj ndërmjet moshave 6-16 vjeç, të cilët e kanë braktisur shkollën para se të përfundonin arsimin bazë kanë mundësinë të marrin pjesë në programin e "Shansit të dytë" të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.²⁹ Pjesëmarrësit në program bëjnë një vit mësim intensiv për t'i dhënë mundësinë për të ri-hyrë në klasat standarde vitin e ardhshëm për të vazhduar arsimim bazë. Gjithashtu programi ofron dhe mësim plotësues për gjuhën shqipe. Ndërsa programi është i hapur në parim për të gjitha etnitë, shumica e pjesëmarrësve janë romë. Në disa vendbanime, probleme me sjelljen ndaj romëve të mësuesve të punësuar për të dhënë mësim për programin kanë çuar në organizmin e trajnimeve plotësuese për mësuesit dhe mobilizimin e mësuesve asistentë romë.

Në nivelin e arsimit të mesëm, pavarësisht dispozitave në dokumentet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të subvencionuar librat shkollorë dhe për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve dhe fëmijëve mbi rëndësinë e arsimit, ka shumë pak informacion të mundshëm mbi çfarë është bërë për të mbështetur pjesëmarrjen e romëve në arsimin e mesëm. Në anën tjetër, në nivelin e arsimit universitar Ministria e Arsimit dhe Shkencës ofroi një total prej 30 vendesh në universitetet publike për studentët romë në vitin akademik 2010-2011.

PJESËMARRJA NË ARSIM

Të dhëna të mbledhura nga UNICEF-i në 2007 dëshmojnë se 62% e romëve të moshës tre deri gjashtë vjeç nuk i frekuentojnë kopshtet ose shkollat.³⁰ Lidhur me arsimin parashkollor në veçanti, UNDP-ja raporton se përqindja e pjesëmarrjes është vetëm 13,5 ndër fëmijët e moshës tre deri pesë vjeç.³¹ Frekuentimi i shkollës ndër fëmijët romë të moshës 6-16 vjeç varion shumë nga rajoni në rajon, por në nivel shtetëror mesatarja është e ulët me 46,5 % për meshkujt dhe 44,5% për femrat.³² Në kontrast, Ministria e Arsimit dhe Shkencës raporton një përqindje për

²⁹ Shih Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Udhëzim nr. 34, datë 08.12.2004, *Për zbatimin e projektit "Shansi i dytë" për arsimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe fëmijët që janë ngujuar për shkak të gjakmarrjes* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2004).

³⁰ Adem Tamo dhe Theodori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 16.

³¹ United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania [Në rrezik: Prekshëmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]*. (Tiranë: UNDP Albania, 2006).

³² Adem Tamo dhe Theodori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 16.

përfundimin e arsimit të detyrueshëm prej 99% për popullsinë e përgjithshme. Megjithëse përqindja e frekuentimit është më e lartë ndër vajzat romë të moshës 6–9 vjeç, se sa djemve romë të së njëjtës moshë, situata ndryshon pas moshës 10-vjeçare.³³ Ndërsa klasa më e lartë e përfunduar nga romët të moshës 6-16 vjeç është paraqitur në tabelën e mëposhtme, raporti i përgjithshëm i popullsisë romë që ka mbaruar arsimin e mesëm apo të lartë është afërsisht 7%.

TABELA 1. Klasat e ndjekura nga fëmijët romë të moshës 6-16 vjeç

Moshë	Sa klasë kanë ndjekur										
	Asnjë klasë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
6	73,1%	26,9%									
7	51,0%	41,3%	7,7%								
8	37,5%	21,7%	34,7%	6,1%							
9	30,9%	7,9%	25,7%	33,1%	2,6%						
10	34,2%	7,2%	11,1%	23,5%	20,5%	3,4%					
11	29,0%	6,3%	8,6%	16,2%	19,5%	17,8%	2,6%				
12	26,8%	3,7%	9,5%	16,1%	16,8%	12,1%	12,4%	2,7%			
13	31,2%	3,5%	5,7%	13,9%	10,4%	8,8%	14,8%	11,0%	6%		
14	34,6%	4,3%	7,0%	8,9%	12,8%	7,3%	7,6%	8,9%	8,6%		
15	42,9%	4,0%	6,3%	6,3%	7,5%	7,1%	7,1%	3,2%	13,9%	1,6%	
16	44,8%	2,0%	3,6%	5,2%	9,9%	8,7%	4,0%	4,8%	11,9%	3,2%	2,0%

BURIMI: UNICEF and Save the Children.³⁴

Siç tregohet në tabelën e mëposhtme, përqindjet e shkollimit ndër romët dhe egjiptianët janë të ulëta, veçanërisht kur i krahason me përqindjen e shkollimit të përgjithshëm të të rriturve në Shqipëri që është 99%.³⁵

TABELA 2. Përqindjet e shkollimit ndër romët dhe egjiptianët në Shqipëri

Grupet sipas moshës	Përqindja e shkollimit	
	Romët	Egjiptianët
7–20	36%	76%
15–16	57%	Nuk ka të dhëna
20–40	60%	89%

BURIMI: UNICEF and Save the Children.³⁶

³³ Ibid.

³⁴ Ibid.

³⁵ Shih United Nations Development Programme, "Adult Literacy Rate (% Aged 15 and Above [Niveli i alfabetizmit ndër të rriturit (% 15 vjeç e sipër)]", e disponueshme në <http://hdrstats.undp.org/en/indicators/89.html>.

³⁶ Ibid.

Informacioni i disponueshëm sugjeron se pengesa më e madhe për pjesëmarrjen e romëve në arsim në Shqipëri është situata financiare e familjes, si rezultat i së cilës punësimit të fëmijës i jepet më prioritet se frekuentimit të shkollës.³⁷ Gjithashtu i zakonshëm është dhe emigrimi sezonal për punë, veçanërisht në Greqi, me rezultatin që fëmijët romë të humbin të paktën një pjesë të vitit shkollor. Ajo që e komplikon më shumë është mungesa e të dhënave mbi romët në Shqipëri në përgjithësi dhe mbi romët në sektorin e arsimit në veçanti që e ul efektshmërinë e mundshme të aktiviteteve për të mbështetur arsimimin e romëve.

PËRMBLEDHJE MBI PROGRESIN DHE DOBËSITË E MBETURA NË ARSIM PER ROMËT NË SHQIPËRI

Megjithëse është bërë progres i rëndësishëm në lidhje me arsimimin e romëve në Shqipëri, shumë çështje mbeten akoma për t'u adresuar në mënyrë që të arrihet një reduktim i qëndrueshëm i hendekut në arsim midis romëve dhe jo-romëve.

Fushat e progresit

Përparime të rëndësishme lidhur me arsimimin e romëve në Shqipëri në vitet e fundit përfshijnë:

- Përmirësime të përgjithshme në sistemin arsimor të cilat prekin të gjithë fëmijët, si rritja e rrogave të mësuesve, rinovimi i laboratorëve, dhe zgjatja e arsimit të detyrueshëm në 9 vjet.
- Miratimi i politikave që synojnë të sigurojnë aksesin e të gjithë fëmijëve për të pasur libra shkollorë.
- Rikonstruktimi i disa shkollave në zona me popullsi të lartë rome.
- Miratimi i Planit Veprues Kombëtar për Dekadën e Përfshirjes së Romëve.
- Shtimi i ambienteve për arsimin parashkollor.
- Miratimi i një udhëzimi që lejon fëmijët pa dokumente të regjistrimit civil të regjistrohen në shkollë.
- Futja e programit “Shansi i dytë” për të rinjtë që kanë braktisur shkollën.

Dobësitë kryesore

Nga pikëpamja e kualitetit të arsimit për romët, dobësitë më të rëndësishme të sistemit të arsimit në Shqipëri lidhen me pikat e mëposhtme:

- Përqindjet shumë të ulëta të përfshirjes së romëve në të gjitha nivelet e arsimit, që shton përjashtimin dhe lë fëmijët romë në rrezik trafikimi.
- Diskriminimi kundrejt fëmijëve romë në shkolla, duke përfshirë (por jo vetëm) dhe uljen e nxënësve romë veç nga fëmijët e tjerë.

³⁷ Shih United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania [Në rrezik: Prekshmeria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]*. (Tiranë: UNDP Albania, 2006).

- Mungesë vëmendjeje për romët në arsimin e përgjithshëm dhe mospërfshirja e tyre në kurrikulën trajnuese të mësuesve si një pjesë integrale e historisë dhe kulturës së Shqipërisë.
- Vazhdimësia e pengesave administrative për romët për të pasur akses në arsim.
- Mungesa e një databaze të përshtatshme mbi popullsinë rome në përgjithësi dhe mungesa e një përmbledhjeje sistematike të dhënash mbi nxënësit romë në veçanti si bazë për hartimin dhe monitorimin e masave të duhura me objektiv pengesat më të rëndësishme për arsimimin e romëve.
- Mungesa e një mekanizmi të unifikuar për të vlerësuar kualitetin e programeve të ndryshme parashkollore për fëmijët romë.
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm i autoriteteve arsimore dhe shkollave me prindërit romë.





REF NË SHQIPËRI

PROJEKTE NË MBËSHTETURA

Deri në fund të 2010, REF-i ka marrë 14 propozime për projekte nga Shqipëria, pesë nga të cilat u aprovuan. Financimi total i REF-it për këto projekte ka qenë afërsisht 421.000 EUR.

Nga 2006 në 2008, UNICEF-i në Shqipëri dhe Amarodrom zbatuan një projekt me mbështetjen e REF-it i cili u fokusua në advokim për të përmirësuar implementim e Strategjisë Rome, një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e regjistrimit të lindjeve për arsimin dhe rritjes së përfshirjes së fëmijëve romë në arsimin parashkollor. Shtatë OJQ romë dhe 200 mësues, pesë administrata të rretheve dhe një numër liderash të komunitetit rom u përfshinë në këtë projekt. REF-i e vlerësoi projektin si praktikë të mirë. Në monitorimin e fundit stafi i REF-it vuri re se sfidat përfshinin nevojën për t'i kushtuar vëmendje balancimit etnik dhe komunikimit me prindërit jo-romë. UNICEF-i në Shqipëri advokoi me sukses për rekomandimet të cilat fokusohen që përfshirja sociale të bëhet pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Rezultate të tjera pozitive përfshijnë:

- Certifikata lindje të lëshuara për 130 fëmijë të porsalindur romë, si dhe 1000 të rritur romë të informuar për rëndësinë e regjistrimit të lindjeve.
- 150 fëmijë frekuentuan institucionet parashkollore dhe me një total prej 500 familjesh romë të informuar për përfitimet e arsimit parashkollor dhe fillor.
- 1000 fëmijë përfituan nga metodologji të reja për mësimdhënie shumëkulturore.

REF mbështet dhe punën e organizatës Romani Baxt për të promovuar akses në arsimin e përgjithshëm për fëmijët romë në Tiranë dhe Fier. Projekti ofron klase plotësuese, një shkollë verore dhe ndërgjegjëson prindërit për regjistrimin e lindjeve dhe atë në shkollë. Në fazën e parë që zgjati nga janari 2009 deri në shkurt 2010, projekti arriti të regjistronte 53 fëmijë në shkollat fillore publike, duke ofruar gjithashtu mësim parashkollor për 89 fëmijë. Faza e dytë e projektit synon të përmirësojë më tej këto rezultate dhe zgjatë deri në gusht 2011.

Iniciativa e tretë e financuar nga REF në Shqipëri mbështeti një program bursash për studentët romë dhe egjiptianë në Qendrën për Studime Politike në Universitetin Evropian të Tiranës. Qendra mori aprovimin e universitetit për të dhënë dy deri në katër bursa për studentë romë dhe egjiptianë çdo vit akademik. Si rezultat, janë mbi 10 studentë romë dhe egjiptianë që studiojnë në Universitetin Evropian të Tiranës.

Duke filluar nga prilli 2009, Save the Children në Shqipëri ka punuar me një projekt që mbështet zhvillimin e edukimit gjithëpërfshirës në katër shkolla dhe katër kopshte në dy zona pilote në Shqipëri ku jetojnë një numër i konsiderueshëm fëmijësh romë dhe egjiptianë. Staf i REF-it ndërmoi një vizitë monitoruese në qershor 2010 dhe gjeti se zbatuesit e projektit kishin qenë të suksesshëm në integrimin e fëmijëve romë në shkollat publike. Në një nga lokalitetet e projektit, Gjirokastër, është krijuar një ambient shkollor me emrin "Bashkë" si një iniciativë komunitare i frekuentuar nga 74 fëmijë nga të cilët 20 romë dhe 10 egjiptianë. Ndër sfidat për pjesën e mbetur të zbatimit të projektit do të jetë transferimi i modelit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe shoqërisë civile në Gjirokastër në rajonet e tjera të vendit.

BURSAT

REF e shtriu Programin e tij të bursave për arsimin e lartë edhe në Shqipëri në 2008. Për vitin akademik 2008–2009, të katërta aplikimet për Programin e Bursave të Universitetit Memorial për Romët (RMUSP) u aprovuan. Për vitin akademik 2009–2010, u aprovuan 10 nga 13 aplikimet e marra (përshirë këtu dhe 4 studentët e 2008–2009). Për vitin akademik 2010–2011, numri i aplikimeve u rrit ndjeshëm me 31 aplikime, nga të cilat u aprovuan 17 (duke përfshirë 7 rinovime).

Bursantët e mbështetur me bursën RMUSP përfitojnë një bursë mujore prej 80 EUR gjatë 10 muajve të vitit akademik për të mbuluar shpenzimet kryesore të jetesës dhe disa nga shpenzimet e tjera të lidhura me studimet. Studentët që paguajnë tarifë për regjistrimin kanë mundësi të marrin një shtesë në proporcion me tarifën. Shpenzimet e Programit të Bursave në Shqipëri deri me tani kap shumën prej 27.750 EUR.³⁸

UDHËZIME STRATEGJIKE PËR AKTIVITETET E ARDHSHME TË REF-IT

Financimi i REF në Shqipëri për 3 vitet e ardhshme do të marrë parasysh prioritetet e mëposhtme:

- Të sigurojë akses për fëmijët romë për të pasur arsimim parashkollor cilësor dhe të integruar.
- Të parandalojë braktisjen e hershme të shkollës nëpërmjet masave që përshijnë rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rëndësinë e arsimimit, sigurimin e mbështetjes materiale (p.sh. ushqim, mjete shkollore, libra shkollore) e nevojshme për pjesëmarrjen në shkollë, dhënien e mbështetjes pas shkollës në vitet e para të arsimit bazë dhe promovimin e edukimit ndërkulturor me stafin e mësuesve dhe administratën shkollore.
- Të mbështesë projekte pilote në fushën e arsimimit të të rriturve si një mjet për të rritur kapacitetet e prindërve romë për të mbështetur edukimin e fëmijëve të tyre ndërsa kontribuojnë njëkohësisht dhe për punësimin e tyre.

³⁸ 4.000 USD në 2008-2009, 8.800 EUR në 2009-2010 dhe 15.930 EUR në 2010-2011.

Të krijojë mundësinë për mbështetje akademike për studentë në arsimin e mesëm dhe të lartë, duke u nisur nga eksperiencia e REF në Hungari, Maqedoni dhe Serbi.

Duke ndjekur prioritetet e rëndësishme të listuara më lart, REF gjithashtu do të merret me zhvillimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, do të promovojë koordinim ndërmjet donatorëve aktivë me romët në Shqipëri dhe mundësi fondesh nga qeveritë qendrore dhe vendore. Pasi egjiptianët dhe të tjerë në Shqipëri hasin të njëjtat probleme me romët për të pasur akses në arsim cilësor, anëtarët e këtyre grupeve gjithashtu përbëjnë kandidatë t'u përfshirë në aktivitetet e mbështetura nga REF.

Prioritetet e REF për kërkimin dhe analizën e politikave

Çështjet kryesore të kërkimit dhe aktiviteve mbi politikën në Shqipëri do të përfshijnë:

– *Një vlerësim me metodologji të mirëfilltë kualitative dhe/ose kuantitative për përfaqësimin e romëve në arsimin special.*

Duke ndjekur studime të ngjashme të bëra nga ose në bashkëpunim me REF në vende të tjera të Dekadës, gjetjet e këtij vlerësimi do të ofrojnë bazën për të hartuar masa në bashkëpunim me qeverinë shqiptare për të adresuar këtë çështje, si dhe për të vendosur prioritetet shtesë për financimet e projekteve të REF.

– *Një përmbledhje mbi iniciativat e qeverisë lokale për të përmirësuar situatën e shkollimit të romëve.* Identifikimi i bashkive të cilat kanë bërë hapa për të promovuar arsim cilësor dhe të integruar për komunitetet rome vendase do të shërbejnë si bazë për të krijuar lidhje dhe mbështetje.

Përveç aktivitetet të listuara më sipër, REF do të ndajë informacion dhe materiale të nxjerra në kuadër të projektit pilot të financuar nga Bashkimi Evropian "Një fillim i mbarë", të cilin REF po e zbaton që nga qershori 2010 deri më prill 2012 në Hungari, Maqedoni, Rumani dhe Sllovaki.

Programet e bursave të REF

Përveç administrimit të bursave ekzistuese, prioritetet zhvillimore të Programit të Bursave të REF-it në Shqipëri do të përfshijnë:

– *Rritjen e numrit të bursantëve të RMUSP.* Shpërndarja e informacionit, ku një theks të veçantë do t'i vihet zonave rurale dhe atyre të marginalizuara, duhet të ndërmerret nga qendrat këshillimore të drejtuara nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur për Shqipërinë në Elbasan, Gjirokastër, Korçë dhe Shkodër., si dhe me anë të media së shkruar dhe elektronike.

– *Një rrjet i përfituesve.* Krijimi i një infrastrukture të centralizuar (një rrjet) duhet të plotësohet me konsultime me përfituesit e Programit të Bursave në Shqipëri si anëtarë të mundshëm të rrjetit mbi rolet dhe funksionet që ky rrjet duhet të plotësojë. Aktivitetet të lançuara në vend dhe/ose në nivel ndërkombëtar duhet të planifikohen në përputhje me prioritetet.

- *Promovimi i pjesëmarrjes së bursantëve në aktivitete të tjera të REF.* Përfituesit e Programit të Bursave me rezultate shumë të mira duhet të inkurajohen për zhvillim e tyre personal/profesional (por jo si një kusht për marrjen e bursës) duke marrë pjesë në aktivitetet jo-akademike të organizuara nga REF-i, përfshirë dhe marrjen pjesë në misionet e monitorimit në vendin e tyre.

REZULTATET E PRITURA NGA AKTIVITETET E REF-IT

Bazuar në identifikimin e prioritetëve strategjike të REF-it, rezultatet e aktiviteteve të REF-it duhet të jenë të dukshme në dy-tri vitet e ardhshme në nivelet e mëposhtme:

Ndryshime ligjore, financiare dhe administrative

- Rishikimi i të gjitha politikave të tanishme për pajisjen me libra shkollorë për të eliminuar ose reduktuar barrën ekonomike të imponuar nga skema e rimbursimeve.
- Futja e programeve me ushqim në shkolla që shërbejnë për komunitete të banuar kryesisht nga romë të varfër.

Indikatorë kryesorë për arsimin (të dhëna bazë)

- *Regjistrimi në arsimin parashkollor të fëmijëve nga komunitete të varfra romë.* Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 516 fëmijë romë u regjistruan në kopshte publike në vitin shkollor 2010–2011.
- *Numri i romëve që kanë mbaruar arsimin bazë.* Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 304 fëmijë romë kanë mbaruar arsimin bazë në vitin shkollor 2010–2011.
- *Regjistrimi i romëve në arsimin e mesëm dhe të lartë.* Të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin 2010-2011 tregojnë se 56 romë janë të regjistruar në arsimin e mesëm, ndërsa një total prej 85 romësh në arsimin e lartë.

Kohezion social

- Ulja e diskriminimit në klasa si rezultat i përmirësimit të qëndrimit dhe sjelljes së mësuesve dhe drejtorëve të shkollave kundrejt fëmijëve romë.





ANEKS 1: INDIKATORËT KRYESORË PËR ARSIMIN

TABELA A1. Indikatorët kombëtarë për arsimin

Shënim: Kutitë bosh në tabelën e mëposhtme tregojnë që të dhënat përkatëse mungojnë

INDIKATORËT (%)	ROMËT	POPULLSIA E PËRGJITHSHME		
	Të dhëna zyrtare ³⁹	Përlllogaritje të dhëna jozyrtare	Të dhëna zyrtare ⁴⁰	Përlllogaritje jozyrtare
1 Përdorimi i shërbimeve të kujdesit të hershëm (mosha 0–3)	–	–	–	–
2 Regjistrimi në arsimin parashkollor (ISCED 0)	516	13,5% ⁴¹ 148 ⁴²	51%	–
3 Regjistrimi në klasën e parë të arsimit bazë (ISCED 1)	547	27% ⁴³	37.632	–
4 Fëmijë të moshës shkollore në shkolla (ISCED 1 dhe 2)	2.888	45,6% ⁴⁴	399.504	–
5 Fëmijë që fillojnë arsimin bazë (ISCED 1) të cilët nuk mbarojnë ciklin e parë të arsimit të detyrueshëm	177	54% ⁴⁵	0,28% ⁴⁶	–
6 Fëmijë që fillojnë arsimin bazë (ISCED 1) të cilët nuk mbarojnë ciklin e dytë të arsimit të detyrueshëm ⁴⁷	66	54% ⁴⁸	0,65%	–
7 Fëmijë që fillojnë arsimin bazë (ISCED 1) të cilët nuk mbarojnë ciklin e tretë të arsimit të detyrueshëm (nqs ekziston)	Nuk ka	–	–	–

³⁹ Të dhënat në këtë kolonë janë dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe janë për vitin shkollor 2010-2011.

⁴⁰ Të dhënat në këtë kolonë janë dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Përveç rasteve ku shënohet ndryshe, të gjitha të dhënat janë të vitin shkollor 2010-2011.

⁴¹ United Nations Development Programme in Albania, *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania* [Në rrezik: Prekshëmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]. (Tiranë: UNDP Albania, 2006).

⁴² Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 11.

⁴³ Ibid., f. 11.

⁴⁴ Ibid., f. 15.

⁴⁵ Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 11. Numri në këtë kuti është përqindja e fëmijëve romë, të cilët regjistrohen në arsimin bazë, por që nuk e përfundojnë arsimin e detyrueshëm.

⁴⁶ Numri në këtë kuti është përqindja e numrit total të fëmijëve, të cilët regjistrohen në arsimin bazë, por që nuk e përfundojnë ciklin e parë të arsimit të detyrueshëm.

⁴⁷ E shprehur si përqindje e numrit total të fëmijëve, të cilët regjistrohen në arsimin bazë.

⁴⁸ Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 11. Numri në këtë kuti është përqindja e fëmijëve romë, të cilët regjistrohen në arsimin bazë, por që nuk e përfundojnë arsimin e detyrueshëm.

INDIKATORËT (%)	ROMËT	POPULLSIA E PËRGJITHSHME		
	Të dhëna zyrtare	Përlogaritje jozyrtare	Të dhëna zyrtare	Përlogaritje jozyrtare
8 Nxënës në arsimin e detyrueshëm (ISCED 1 dhe 2) që ndjekin klasa dhe shkolla speciale	–	–	200	–
9 Nxënës që përfundojnë arsimin e detyrueshëm në programe të ciklit të mesëm të ulët (ISCED 2C)	417	–	209	–
10 Nxënës që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe fillojnë arsimin e mesëm (ISCED 3)	22 ⁴⁹	5% ⁵⁰	118.306	–
11 Regjistrim në arsimin e mesëm teknik ose profesional (ISCED 3C) që nuk siguron akses në arsimin e lartë	<i>Nuk ka</i>			
12 Përfundimi i shkollës së mesme (ISCED 3)	15	4,3% ⁵¹	–	–
13 Regjistrimi në arsimin pas shkollës mesme por që nuk është arsim i lartë (ISCED 4)	–	–	–	–
14 Përfundimi i arsimit pas shkollës mesme por që nuk është arsim i lartë (ISCED 4)	–	–	–	–
15 Regjistrimi në arsimin e lartë (ISCED 5 dhe 6)	85	–	134.877 ⁵²	–
16 Përfundimi i arsimit të lartë (ISCED 5 dhe 6)	–	0,2% ⁵³	82.358 ⁵⁴	–

⁴⁹ Numri i romëve në vitin e dytë dhe të tretë të arsimit të mesëm gjatë vitit shkollor 2010-2011 ishte respektivisht 19 dhe 15.

⁵⁰ Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri* (Tiranë: UNICEF dhe Save the Children, 2007), f. 11.

⁵¹ Të dhëna nga sondazhi i Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në 2005 "Vulnerable Groups in Central and South Eastern Europe [Grupe në rrezik në Evropën Qendrore dhe Juglindore]", cituar në Open Society Institute, *Monitoring Education for Roma: A Statistical Baseline for Central, Eastern, and South Eastern Europe [Programi për Përkrahjen e Edukimit, Monitorimi i Edukimit të Romëve: Baza Statistike për Evropën Qendrore dhe Juglindore]* (New York: Open Society Institute, 2006), f. 15.

⁵² Të dhëna për vitin akademik 2009-2010.

⁵³ Të dhëna nga sondazhi i Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në 2005 "Vulnerable Groups in Central and South Eastern Europe [Grupe në rrezik në Evropën Qendrore dhe Juglindore]", cituar në Open Society Institute, *Monitoring Education for Roma: A Statistical Baseline for Central, Eastern, and South Eastern Europe [Programi për Përkrahjen e Edukimit, Monitorimi i Edukimit të Romëve: Baza Statistike për Evropën Qendrore dhe Juglindore]* (New York: Open Society Institute, 2006), f. 21.

⁵⁴ Të dhëna për vitin akademik 2009-2010.

ANEKS 2: ADMINISTRATA E ARSIMIT PUBLIK

TABELA A2. Administrata e arsimit publik

FUNSIONI	ORGANET PËRGJEGJËSE SIPAS NIVELIT TË ARSIMIT				
	Fëmijëria e hershme (mosha 0–3)	Parashkollor	Bazë	I mesëm	I lartë
1 Hap dhe mbyll institucione	– Qeveria lokale – Ministria e Shëndetit	– Qeveria lokale – Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)	– Qeveria lokale – MASH	– Qeveria lokale – MASH	– Këshilli i Ministrave
2 Financon institucione	– Qeveria lokale	– Qeveria lokale – MASH	– Qeveria lokale – MASH	– Qeveria lokale – MASH	– Rektorati i universitetit
3 Vendos për pranimet	– Qeveria lokale	– Drejtoria Arsimore Rajonale ⁵⁵	– Drejtoria Arsimore Rajonale ⁵⁶	– Drejtoria Arsimore Rajonale ⁵⁷	– Rektorati i universitetit
4 Vendos kurikulën	– Çerdhja – Drejtoria Arsimore Rajonale	– MASH	– MASH	– MASH	– Rektorati i universitetit
5 Cakton mësuesit në institucione	– Qeveria lokale	– Zyra Arsimore Lokale – Drejtoria Arsimore Rajonale	– Zyra Arsimore Lokale – Drejtoria Arsimore Rajonale	– Zyra Arsimore Lokale – Drejtoria Arsimore Rajonale	– Rektorati i universitetit

⁵⁵ Vendimet për pranime bëhen në përputhje me një plan të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

⁵⁶ Vendimet për pranime bëhen në përputhje me një plan të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

⁵⁷ Vendimet për pranime bëhen në përputhje me një plan të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

FUNSIONI	ORGANET PËRGJEGJËSE SIPAS NIVELIT TË ARSIMIT				
	Fëmijëria e hershme (mosha 0-3)	Parashkollor	Bazë	I mesëm	I lartë
6 Vlerëson performancën e institucioneve	– Qeveria lokale – Ministria e Shëndetit	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Rektorati i universitetit
7 Vlerëson performancën e nxënësve	– Qeveria lokale – Ministria e Shëndetit	– Stafi i shkollës (mësuesit, punonjësit socialë, drejtorë) – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Stafi i shkollës (mësuesit, punonjësit socialë, drejtorë) – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Stafi i shkollës (mësuesit, punonjësit socialë, drejtorë) – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Instrukturët e lëndës – Përgjegjësi i departamentit – Rektorati i universitetit
8 Vlerëson performancën e mësuesve	– Qeveria lokale	– Drejtori i kop-shteve – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtori i shkollës 9-vjeçare – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtori i shkollës së mesme – Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Përgjegjësi i departamentit – Rektorati i universitetit
9 Vlerëson performancën e drejtorëve	– Qeveria lokale	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Drejtoria Arsimore Rajonale – Inspektorati Kombëtar për Arsimin Parashkollor	– Rektorati i universitetit

FUNSIONI	ORGANET PËRGJEGJËSE SIPAS NIVELIT TË ARSIMIT				
	Fëmijëria e hershme (mosha 0–3)	Parashkollor	Bazë	I mesëm	I lartë
10 Hap dhe mbyll shkolla speciale	– Nuk ka	– Nuk ka	– Këshilli i Ministrave	– Nuk ka	– Rektorati i universitetit
11 Financon shkolla speciale	– Nuk ka	– Nuk ka	– MASH	– Nuk ka	–
12 Vendos për pranime në shkollat speciale	– Nuk ka	– Nuk ka	– Drejtori i shkollës speciale	– Nuk ka	–
13 Vendos kurrikulën për shkollat speciale	– Nuk ka	– Nuk ka	– Drejtori i shkollës speciale – MASH	– Nuk ka	–

ANEKS 3: PERFORMANCA E NXËNËSVE NË VLERËSIMET NDËRKOMBËTARE

Shqipëria mori pjesë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) për herë të parë në 2009. Deri tani, Shqipëria nuk ka marrë pjesë në vlerësime të tjera të rëndësishme, si p.sh. Tendenca në Matematikën Ndërkombëtare dhe Studimet Shkencore (TIMSS) dhe Progresi në Studimin Ndërkombëtar për Shkrim dhe Lexim (PIRLS) në 2001 dhe 2006.

Siç pasqyrohet në tabelën më poshtë, Shqipëria arriti rezultate të cilat ishin shumë më poshtë se mesatarja e vendeve të OECD-së në të tria fushat e testuara me rezultatet më të ulëta në fushën e matematikës dhe më të lartat në shkencat natyrore. Rezultate kaq të dobëta vënë në pikëpyetje konkurrueshmërinë e Shqipërisë në skenën ndërkombëtare.

TABELA A3. Rezultatet e PISA 2009

Fusha	Shqipëria		OECD		Diferenca e mesatares Shqipëri-OECD
	Mesatarja	S.E.	Mesatarja	S.E.	
Matematikë	377	4,0	496	0,5	-119
Lexim	385	4,0	493	0,5	-108
Shkencë	391	3,9	501	0,5	-110

BURIMI: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim⁵⁸

⁵⁸ Organisation for Economic Co-operation and Development, *PISA 2009 Results: What Students Know and Can Do — Student Performance in Reading, Mathematics and Science (Volume 1)* [Rezultatet e PISA 2009: Çfarë dinë dhe mund të bëjnë nxënësit- Performanca e nxënësve në lexim, matematikë dhe shkenca natyrore (Vëllimi 1)] (Paris: Organisation for Economic Co-operation and Development, 2010).

ANEKS 4: NIVELI I ANGAZHIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E REZULTATEVE TË ARSIMIMIT TË ROMËVE NË SHQIPËRI

Asistencë dhe mbështetje për komunitetin rom

1. Përgatitja e mësuesve romë në arsim.

- Veprime afirmative duhet të ndërmerren dhe zbatohen për të tërhequr romët në profesionin e mësuesit.

2. Mbështetja e prindërve dhe liderëve të komunitetit rom për të identifikuar dhe për t'u marrë me çështjet kryesore në arsim:

- Inkurajimi i prindërve romë për të luajtur një rol aktiv në bordet e shkollës dhe organizatat e prindërve.
- Identifikimi i diskriminim në

Mbështetje për autoritet arsimore

1. Mbështetja e zhvillimeve të tanishme në arsim duke siguruar që romët të mos lihen jashtë ose të rrezikohen prej tyre:

- Dhënia e asistencës institucioneve që merren me trajnimin e mësuesve.
- Dhënia e asistencës teknike shkollave fillore për futjen e gjuhës dhe kulturës rome në hapësirës e lejuar nga kurrikula.

2. Rritja e fokusit në për- mirësimin e cilësisë në sistemin arsimor:

- Zgjerimin e mbulimit me arsimin parashkollor të integruar për komunitetet rome.
- Krijimin e një sistemi për ndihmë në mësim dhe klasa plotësuese për fëmijët romë të moshës 7–9 vjeçare.

Zhvillimi i politikave me qeverinë

1. Futja e arsimit parashkollor të detyrueshëm.

- Asistencë teknike duhet t'i jepet qeverisë qendrore dhe vendore për hartimin e politikave për ta bërë arsimin parashkollor falas dhe të integruar të detyrueshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë.

2. Institucionalizimi i veprimeve pozitive.

- Veprime pozitive për arsimin e mesëm dhe të lartë duhet të bëhen politika kombëtare duke ndjekur dispozitat e rëndësishme të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007–2013, Planin Veprues Kombëtar të miratuar

Asistencë dhe mbështetje për komunitetin rom

- shkolla dhe veprime kundër tij.
- Monitorimi i regjistrimeve dhe progresit në sistemin arsimor.

3. Krijimi i një sistemi arsimor mbështetës për fëmijët romë në nivelin familjar:

- Duke motivuar prindërit për t'i regjistruar fëmijët në kohë.
- Duke krijuar kohë dhe hapësirë për detyrat e shtëpisë.

Mbështetje për autoritet arsimore

- Fillimi i mbështetjes akademike për romët në arsimin e mesëm dhe të lartë.

3. Përmirësimi i lidhjeve midis sistemit arsimor dhe mbështetjes sociale.

- Një kuadër administrativ për veprime pozitive duhet të krijohet dhe zbatohet në të gjithë vendin.

4. Mbështetja e bashkëpunimit midis OJQ-ve romë, shkollave dhe qeverisë lokale:

- Shkëmbimi i eksperiencave.
- Ndihmë në aktivitete të përbashkëta.

Zhvillimi i politikave me qeverinë

në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve dhe Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom.

3. Financimi i shkollave në bazë të numrit të nxënësve.

- Mbështetja në këtë drejtim është e nevojshme për një rishpërndarje të burimeve në ato zona ku ato nevojiten më shumë, sidomos shkolla që ndodhen në afërsi të komuniteteve të mëdha romë.

4. Promovimi i përfshirjes së Romëve në politikën arsimore:

- Rritja e kapaciteteve të Komitetit Shtetëror për Minoritete për të adresuar çështje që kanë lidhje me arsimimin e romëve.
- Lehtësimi i dialogut mbi çështjet që lidhen me arsimin ndërmjet Komitetit Shtetëror të Minoriteteve dhe institucioneve të tjera të rëndësishme qeveritare

ANEKS 5: REZULTATET E CENSUSIT

Pasi censusi i 2001 në Shqipëri nuk përfshiu pyetje mbi identitetin etnik apo linguistik, nuk ka statistika zyrtare për strukturën e popullsisë sipas etnive.

Duke pasur parasysh se mungesa e të dhënave të besueshme mbi popullsinë rome përbën një pengesë të madhe për përpjekjet për përmirësimin e gjendjes së arsimimit të romëve në Shqipëri, REF-i inkurajon Institutin e Statistikave, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe të tjera institucione që të mbledhin rregullisht dhe të mbajnë të dhëna të ndara sipas etnive në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave.

BIBLIOGRAFIA

Abdikeeva, Alpha.

2005. *Roma Poverty and the Roma National Strategies: The Cases of Albania, Greece and Serbia* [Varfëria e Romëve dhe Strategjitë Kombëtare për Romët: Rastet e Shqipërisë, Greqisë dhe Serbisë]. Londër: Minority Rights Group International.

Commission of the European Communities.

2008. *Albania 2008 Progress Report*. Brussels: Commission of the European Communities.

De Soto, Hermine G., Sabine Beddies, and Ilir Gedeshi.

2005. *Roma and Egyptians in Albania: From Social Exclusion to Social Inclusion* [Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: Nga Përrjashtimi Social në Përfshirjen Sociale]. Washington, D.C.: The World Bank.

Duka, Rajmonda.

2007. *Raport Progresi mbi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom*. Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Dundar, Halil, Maria Eugenia Bonilla-Chacin, Akshay Sethi, Lorena Kostallari, and Florian Tomini.

2005. *Poverty and Education in Albania: Who Benefits from Public Spending?* [Varfëria dhe Arsimi në Shqipëri: Kush përfiton nga fondet publike?]. Washington, DC: The World Bank.

European Commission against Racism and Intolerance.

2010. *ECRI Report on Albania (Fourth Monitoring Cycle)* [Raporti i ECRI mbi Shqipërinë (Cikli i katërt monitorues)]. Strasburg: Council of Europe.

Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë.

1995. Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë), *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr 2.

1995. Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 (Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë). *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr 16.

1999. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 (Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë). *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr 19.

2000. Ligj nr. 8580, datë 17.2.2000. Për partitë politike. *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr 23.

2005. Ligj nr. 9355, datë 14.2.2005. Për përcaktimin e kriterëve, proeedurave dhe masave për ndihmën ekonomike. *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr 98.

Hoxha, Artan, Elira Jorgoni, Ani Plaku, Mimoza Agolli, Artur Lama, Merita Xhumari, Isuf Kalo, Vladimir Gusmari, Etleva Muhedini, and Eglantina Gjermani.

2008. *Social Inclusion and Social Protection in Albania*. Brussels: European Communities.

Ikonomi, Estevan, Bardhyl Musai, Kseanela Sotirofski.

2010. *Mapping Policies and Practices for the Preparation of Teachers for Inclusive Education in Contexts of Social and Cultural Diversity: Albania Country Report [Planifikimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për një arsim gjithëpërfshirës në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor: Raporti vendor për Shqipërinë]*.

Torino: European Training Foundation.

Këshilli i Ministrave.

2003. *Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom*. Tiranë: Fletorja zyrtare.

2008. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013*. Tiranë: Këshilli i Ministrave.

Koinova, Maria.

2000. *Roma of Albania [Romët në Shqipëri]*. Glyka Nera: Center for Documentation and Information on Minorities in Europe - Southeast Europe (CEDIME-SE).

Kolsti, John.

1991. *Albanian Gypsies: The Silent Survivors [Romët shqiptarë: Të mbijetuarit e heshtur]*. Në David Crowe dhe John Kolsti (red.), *The Gypsies of Eastern Europe [Romët e Evropës Lindore]*. Armonk: M.E. Sharpe

Lerch, Mathias, Philippe Wanner.

2008. *Demographic Data in Albania: Results of an Assessment [Të dhëna demografikë në Shqipëri: Rezultate dhe vlerësime]*. Gjenevë: Université de Genève.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2004. *Udhëzim nr. 34, datë 08.12.2004 për zbatimin e projektit "Shansi i dytë" për arsimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe fëmijëve që janë ngjuar për shkak të gjakëmarrjes.* Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2005. *Education for All/Fast Track Initiative (EFA/FTI) Proposal [Propozim për arsimin gjithëpërfshirës/iniciativa përshpejtuese (EFA/FTI)].* Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2008. *Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2009-2013.* Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2005. *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Fëmijët.* Tiranë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Moubayed, Alia.

2006. *Albania Public Expenditure and Institutional Review: Restructuring Public Expenditure to Sustain Growth [Shqipëria: Një Rishikim i Shpenzimeve Publike dhe i Kuadrit Institucional- Ristrukturimi i Shpenzimeve Publike për të Mbështetur Rritjen].* Washington, DC: World Bank.

Open Society Institute.

2006. *Monitoring Education for Roma: A Statistical Baseline for Central, Eastern, and South Eastern Europe [Monitorimi i Edukimit të Romëve: Baza Statistikore për Evropën Qendrore dhe Juglindore].* New York: Open Society Institute.

Organisation for Economic Co-Operation and Development.

2010. *Education at a Glance 2010: OECD Indicators [Arsimi me një shikim 2010: Indikatorët e OECD-së].* Paris: Organisation for Economic Co-Operation and Development.

2010. *PISA 2009 Results: What Students Know and Can Do — Student Performance in Reading, Mathematics and Science (Volume 1) [Rezultatet e PISA 2009: Çfarë dinë dhe mund të bëjnë nxënësit- Përformanca e nxënësve në lexim, matematikë dhe shkenca natyrore (Vëllimi 1)].* Paris: Organisation for Economic Co-Operation and Development.

OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights.

2005. *Republic of Albania Parliamentary Elections 3 July 2005: OSCE/ODIHR Election Observation Mission Report [Raporti i Misionit Mbikëqyrës të Zgjedhjeve të OSCE/ODIHR për Zgjedhet Parlamentare në Shqipëri].* Varshavë: OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

1998. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Presidenti i Perublikës së Shqipërisë.

Tamo, Adem, dhe Theodhori Karaj.

2007. *Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri*. Tiranë: UNICEF dhe Save the Children.

United Nations Development Programme in Albania.

2006. *At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania* [Në rrezik: Prekshmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri]. Tirana: UNDP Albania.

United Nations Development Programme.

2009. "Adult Literacy Rate (% Aged 15 and Above) [Niveli i alfabetizimit ndër të rriturit (% 15 vjeç e sipër)]."
E disponueshme në: <http://hdrstats.undp.org/en/indicators/89.html>.

Copyright © Roma Education Fund, 2011

All rights reserved

Photography by Robert Miskovics.

Graphic design by Anikó Bieder and Balázs Gelsei – cadmium grafiklab.

CONTACT INFORMATION

Roma Education Fund

Mark Center

Teréz körút 46, 1066 Budapest – Hungary

tel.: +36 1 235 8030

fax: +36 1 235 8031

e-mail: info@romaeducationfund.org

web: www.romaeducationfund.org

skype: roma.education.fund

Roma Education Fund – Romania

Vaselor 60 str., Sector 2 Bucharest – Romania

tel.: +40 785 231 910

fax: +40 21 312 5049

e-mail: info@romaeducationfund.ro

web: www.romaeducationfund.ro